



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 93, DATË 08.10.2020

MBI

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “DYNAMICSOUND” SH.P.K.,
LICENCUAR PËR SUBJEKTIN AUDIO “RADIO ONE”, PËR NDRYSHIMIN E
KUSHTEVE TEKNIKE**

Autoriteti i Mediave Audiovizive, i përbërë nga:

Gentian	Sala	Kryetar
Sami	Nezaj	Zëvendëskryetar
Agron	Gjekmarkaj	Anëtar
Gledis	Gjipali	Anëtar
Suela	Musta	Anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen që i përket palëve me:

Kërkues: Shoqëria “Dynamicsound” sh.p.k., licencuar për subjektin audio “Radio One”.

Objekt: Shqyrtimi i kërkesës së shoqërisë “Dynamicsound” sh.p.k., licencuar për subjektin audio “Radio One”, për ndryshimin e kushteve teknike

Baza Ligjore: Neni 19 pika 16 dhe neni 88 i ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

VËREN

Këshilli Kombëtar i Radio Televizionit (sot Autoriteti i Mediave Audiovizive) me vendimin nr. 637, datë 12.11.2007 ka licencuar shoqërinë “Dynamicsound” sh.p.k., për subjektin audio privat “Radio One” (ish Radio B-94, ndryshuar logo me vendim të KKRT-së, nr. 96 datë 27.08.2010, nga Radio B-94 në Radio Eagle, si dhe me vendim të AMA-s nr. 30, datë 15.02.2019, është ndryshuar emri nga Radio Eagle në Radio One) për të mbuluar me sinjal audio FM rrethet Tiranë dhe Durrës. Referuar vendimmarrjeve të AMA-s, zona e shërbimit e subjektit audio “Radio One” është “*Bashkitë Tiranë, Kamëz, Vorë, Durrës, Shijak dhe qarqet Fier dhe Vlorë*”. Afati i vlefshmërisë së licencës së subjektit përfundon në datën 10.12.2021.

Shoqëria “Dynamicsound” sh.p.k., me shkresën, administruar në Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA) me nr. 2692 protokollit, datë 25.09.2020 ka paraqitur kërkesë për ndryshimin e kushteve teknike të licencës, konkretisht ndryshimin e frekuencës dhe të vendndodhjes së stacionit transmetues

nga 99.7 MHz, në pikën e transmetimit Fier (qytet), në frekuencën 97.2 MHz, në pikën e transmetimit Likovun, duke argumentuar se: “... Frekuenca aktuale 99.7 MHz në pikën e transmetimit Fier qytet, interferon sinjalin audio të Transmetuesit Publik (RTSH) me frekuencë 99.8 MHz alokuar për pikën e transmetimit Zvërnec. Gjithashtu zhvendosja e pikës së transmetimit në Likovun realizon mbulim më të mirë me sinjal të qytetit të Fierit”.

Pikat e transmetimit në përdorim nga subjekti “Radio One” janë si më poshtë: Fushë Dajt - 94 MHz, Zvërnec - 101 MHz, Treblovë - 90 MHz, Llogara - 89.2 MHz, Mile - 103.2 MHz, Fier (qytet) - 99.7 MHz dhe Ardenicë - 105.2 MHz.

Drejtoria e Planifikimit të Frekuencave dhe TIK (DPFTIK) pasi administroi shkresën e subjektit audio “Radio One”, me qëllim verifikimin e pretendimeve të tij, kreu matjen në terren të shfrytëzimit të spektrit audio FM, në zonën e shërbimit Qarku Fier. Nga matjet rezultoi se, në këtë zonë shërbimi, në frekuencën që përdor subjekti (99.7 MHz) nga pika transmetuese Fier qytet, për shkak të fushëpamjes me pikën e transmetimit Zvërnec me frekuencë 99.8 MHz, u konstatuan interferenca në sinjalin e Radio Tiranës (RTSH).

Neni 88 i ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar parashikon se: “1. AMA ndryshon kushtet e licencës së transmetimit audio dhe/ose audiovizive ... ç) kur interferencat e dëmshme nuk mund të shmangen në mënyrë tjetër;...”

DPTIK, duke konsideruar rezultatet e monitorimit, bëri studimin e planit të përdorimit të frekuencave radio FM 87.5 – 108 MHz, që shfrytëzohen për transmetime audio, në përfundim të të cilit rezultoi se në pikën e transmetimit Likovun ekzistojnë burime frekuencore të lira ndër të cilat edhe frekuenca 97.2 MHz, e propozuar nga subjekti “Radio One”.

AMA vëren se ndryshimi i kushteve teknike të licencës nuk shoqërohet me efekte financiare.

Për sa më sipër, AMA e gjen të drejtë e të mbështetur kërkesën e shoqërisë “Dynamicsound” sh.p.k., për ndryshimin e kushteve teknike të licencës së subjektit audio “Radio One”,

PËR KËTO ARSYE,

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në mbështetje të nenit 19, pika 16 dhe nenit 88 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës së subjektit, shoqërisë “Dynamicsound” sh.p.k., për ndryshimin e kushteve teknike, dhënien në përdorim të frekuencës 97.2 MHz, në pikën e transmetimit në Likovun, me parametra teknikë sipas tabelës më poshtë:

<i>Pika e transmetimit</i>	<i>Frekuenca MHz</i>	<i>Koordinatat XYZ</i>	<i>Fuqia Nominale (W)</i>	<i>Përforcimi i antenës (dBi)</i>	<i>ERP (Ë)</i>	<i>Azimuth (deg)</i>	<i>Lartësia e antenës (m)</i>	<i>Drejtimi i antenës</i>
Likovun	97.2	19.313201 40.395998 280 4DMS	200	6	385.64	90	20	D

2. Parametrat teknikë të pikave të transmetimit në Fushë Dajt, Zvërnec, Treblovë, Llogara, Mile, Ardenicë mbeten të pandryshuara.

3. Shoqërisë “Dynamicsound” sh.p.k., hiqet e drejta e përdorimit të frekuencës 99.7 MHz, në pikën e transmetimit Fier (qytet).
4. Ngarkohet administrata e AMA-s për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:

Gentian

SALA

Zëvendëskryetar:

Sami

NEZAJ

Anëtarë:

Agron

GJEKMARKAJ

Gledis

GJIPALI

Suela

MUSTA

